



**Republika e Kosovës**  
**Republika Republic of Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LIGJI Nr. 03/L-054**

**PËR VULA NË INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Duke u bazuar në Nenin 65 pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJIN PËR VULA NË INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**KREU I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së vulës, procedurës për mënyrën e punimit, përdorimit, ruajtjes si dhe përgjegjësia për përdorimin e vulës në institucionet e Republikës së Kosovës.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Për qëllimet të këtij ligji, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura më poshtë kanë kuptimet si në vijim:

**“Institucion”**- nënkupton organet e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor të nivelit qendror dhe të nivelit lokal dhe organet në varësi të tyre;

**“Ministria”**- nënkupton Ministrinë e Shërbimeve Publike, apo Ministrinë kompetente për administratë publike.

**“Komisioni”** - nënkupton komisionin e emëruar nga udhëheqësi i institucionit i cili zhvillon procedurën për marrjen e lejes për vulë, porositjen e vulës te vulëpunuesi, mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit, arkivimin e vulës, shpalljen e pavlefshme të vulës dhe veprime të tjera të parapara me dispozitat e këtij ligji.

### **Neni 3**

3.1 Sipas kërkesës së institucionit përkatës, Ministria lejon pajisjen me vulë.

3.2 Leja ose refuzimi i kërkesës për pajisjen me vulë jepet në afat prej tri ditë pune.

3.3 Ministria mban evidencën për lejet e dhëna.

3.4 Institucioni duhet të ketë vetëm një vulë dhe në rastet të veçanta mund të ketë edhe një vulë të vogël.

3.5 Institucionit i lejohet të ketë më shumë ekzemplarë të vulave, nëse ushtron veprimtarinë e tij në më shumë se në një ndërtesë dhe nëse është e arsyeshme sipas kërkesave të punës.

3.6 Nëse ka më shumë ekzemplarë të vulës, atëherë secili ekzemplar shënohet me numrin rendor romak, i cili vihet në mes të stemës së Kosovës dhe emërimit të selisë së institucionit.

### **Neni 4**

4.1 Vula e institucionit shërben për të vërtetuar aktin autentik zyrtar, të cilin e lëshojnë institucionet.

4.2 Me vulë vulosen vetëm ato akte, dokumente dhe shkresa, që janë nënshkruar nga personi i autorizuar.

4.3 Vula vihet në anën e majtë të nënshkrimit të personit të autorizuar për nënshkrim, ashtu që do të mbulojë afërsisht një të katërtën (1/4) e nënshkrimit.

## **KREU II**

### **DISPOZITAT E VEÇANTA**

#### **Neni 5**

5.1 Vula e institucionit ka këtë formë dhe madhësi:

- a) vula ka formë rrethore,
- b) madhësia e vulës është me diametër prej 40 mm, 50 mm dhe 60 mm.

5.2 Madhësia e vulës përcaktohet sipas gjatësisë së tekstit dhe numrit të gjuhëve, të cilat duhet t'i përmbajë vula.

5.3 Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në se me dispozitat e veçanta ligjore në fuqi është paraparë përdorimi i vulës me formë, madhësi dhe përmbajtje tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj, institucioni apo njësia organizative mund të pajiset edhe me atë vulë duke respektuar dispozitat e tjera të këtij ligji.

#### **Neni 6**

6.1 Vula e institucionit ka më shumë rrahë koncentrikë dhe përmban këto të dhëna:

- a) në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: Republika e Kosovës,
- b) në rrahët e tjerë shkruhet emërtimi i institucionit dhe selia e tij dhe
- c) në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit më të vogël të vulës vendoset stema e Republikës së Kosovës.

6.2 Teksti i vulës së institucionit shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Kosovës.

6.3 Teksti i vulës së institucioneve komunale shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të komunave.

6.4 Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat prej tre muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerrë aktin nënligjor për zbatimin e këtij neni.

#### **Neni 7**

7.1 Institucionet mund të kenë vulë të vogël për rastet, në të cilat përdorimi i saj do të ishte më i përshtatshëm për vërtetimin e dokumenteve të një madhësie të vogël, por diametri i saj nuk mund të jetë më i vogël se 20 mm.

7.2 Përmbajtja dhe forma e vulës së vogël është e njëjtë me vulën e paraparë në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji, mirëpo emërtimi i institucionit mund të jetë i shkurtuar, por vetëm në atë masë që të shihet se e kujt është vula.

## **Neni 8**

8.1 Institucionet kanë vulë katrore, e cila përdoret për protokollimin e shkresave.

8.2 Si rregull vula katrore ka dimensionin 35 mm. me 70mm., por sipas nevojës mund të ketë edhe dimensione tjera.

8.3 Vula katrore përmban këto të dhëna sipas renditjes:

- a) në pjesën e epërme të vulës vihet stema e Republikës së Kosovës,
- b) Republika e Kosovës,
- c) emërtimi i institucionit, i shkruar me shkronja të mëdha të shtypit,
- d) emërtimi i njësisë organizative të institucionit,
- e) numri i protokollit i njësisë organizative, në vazhdim lehet hapësira për shënimin e numrit të protokollit të shkresës,
- f) hapësira ku do të shënohet numri i faqeve të bashkangjitura,
- g) hapësira ku do të shënohet dita, muaji dhe viti dhe
- h) vendi i selisë së institucionit.

8.4 Me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria, në afat prej tre muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, caktohen forma e vulës katrore dhe parametrat teknikë të ngjyrës.

## **Neni 9**

9.1 Komunat e Kosovës përdorin vulën me stemën e tyre në ato akte për të cilat nuk janë të obliguara të vendosin stemën e Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit për përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës.

9.2 Vulat e komunave duhet të jenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përjashtimisht përdorimit të stemës së tyre sipas paragrafit një të këtij neni.

## **Neni 10**

10.1. Vula është prej gome, metali apo plastike.

10.2. Ngjyra e vulës është e kaltër.

10.3 Me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria, në afat prej tre muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, caktohen lloji, nuanca dhe parametrat teknikë të ngjyrës.

### **Neni 11**

11.1 Udhëheqësi i institucionit emëron, me vendim, komisionin prej tre anëtarëve, i cili zhvillon procedurën për marrjen e lejes për vulë, porositjen e vulës te vulëpunuesi, mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit, arkivimin e vulës, shpalljen e pavlefshme të vulës dhe veprime të tjera të parapara me dispozitat e këtij ligji.

11.2. Për çdo veprim, komisioni harton procesverbal.

### **Neni 12**

12.1 Në rastet kur ndryshohet emërtimi i institucionit apo për arsye të tjera vula nuk është për përdorim, ajo dërgohet në arkivin kompetent për ruajtje, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat (shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/20.

12.2 Arkivi është përgjegjës për sigurinë dhe ruajtjen e vulës së pranuar.

12.3 Komisioni për vulë lidhur me arkivimin e vulës përpilon procesverbalin në tri kopje identike, prej të cilave nga një kopje iu dërgohet Ministrisë dhe arkivit, ndërsa një kopje e mban në arkivin e institucionit.

### **Neni 13**

13.1 Institucioni përdorues i vulës është përgjegjës për autorësinë dhe vërtetësinë e dokumenteve, në të cilat vihet vula.

13.2 Çdo institucion përdorues i vulës është i detyruar të mbajë evidencë për vulat që i ka në përdorim.

13.3 Ministria e Punëve të Jashtme ndërmerr të gjitha veprimet për njoftimin e subjekteve të jashtme të rëndësishme, lidhur me vulat zyrtare në komunikim me jashtë.

## **KREU III**

### **PUNIMI I VULËS**

#### **Neni 14**

14.1 Vula e institucionit, punohet nga vulëpunuesi i caktuar nga institucioni.

14.2 Vulëpunuesi duhet të ketë të regjistruar veprimtarinë e tij, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për regjistrimin e bizneseve.

#### **Neni 15**

15.1 Vulëpunuesi i vulës obligohet që pas përfundimit të punimit të vulës, nën mbikëqyrjen e komisionit t'i kthejë ose t'i asgjësojë të gjitha modelet, kallëpet si dhe të gjitha gjurmët e tjera, të cilat kanë mbetur gjatë procesit të punimit të vulës.

15.2 Komisioni, për veprimet e parapara me paragrafin një të këtij neni, mban procesverbal në tri kopje identike, të cilin e nënshkruan edhe vulëpunuesi, prej të cilave një kopje i dërgohet Ministrisë, një kopje vulëpunuesit, ndërsa një kopje e mban institucioni në arkivin e tij.

#### **Neni 16**

Vulëpunuesi i autorizuar për punimin e vulës mban përgjegjësi të plotë juridike për vulën, nga momenti i pranimit të porosisë së punimit të vulës e deri në momentin e dorëzimit të saj komisionit të institucionit.

#### **Neni 17**

Vulëpunuesi është i detyruar të mbajë evidencë me shkrim për vulat e punuara.

#### **Neni 18**

Vulëpunuesi është i detyruar të punojë vulën, vetëm sipas porosisë së dhënë, në të kundërtën i merret autorizimi.

## **KREU IV**

### **PËRDORIMI DHE PËRGJEGJËSIA**

#### **Neni 19**

19.1 Udhëheqësi i institucionit, pas pranimit të vulës nga komisioni, nxjerr vendim për datën e fillimit të përdorimit të vulës.

19.2 Udhëheqësi i institucionit autorizon me shkrim personin përgjegjës, i cili do të përdorë vulën.

19.3 Personi përgjegjës për përdorimin e vulës është i detyruar të mbajë evidencë të plotë dhe të saktë, si dhe një kopje të dokumentit të vulosur.

19.4 Vula e institucionit përdoret vetëm brenda selisë së institucionit, përjashtimisht edhe jashtë selisë, por me leje të veçantë të udhëheqësit më të lartë të institucionit.

#### **Neni 20**

Personi përgjegjës mban përgjegjësi për përdorimin e vulës dhe është i detyruar të ruajë vulën, nga shfrytëzimi i paautorizuar i saj.

#### **Neni 21**

21.1 Me rastin e humbjes së vulës apo kur vula bëhet e papërdorshme, lajmërohet menjëherë udhëheqësi i institucionit dhe dhënësi i lejes për pajisje me vulë, në afatin më të shkurtër të mundshëm e jo më larg se 24 orë.

21.2 Menjëherë pas konstatimit të humbjes së vulës ose kur vula nuk është më e përdorshme, me vendim të udhëheqësit të institucionit vula shpallet e pavlefshme.

21.3 Punimi i vulës së re bëhet sipas procedurës së paraparë me këtë ligj dhe përmban numrin rendor romak pasues të vulës së humbur ose të vulës që nuk është në përdorim.

#### **Neni 22**

Jashtë orarit të punës dhe kur vula nuk përdoret, ajo ruhet në kasafortë.

#### **Neni 23**

Ministria bën mbikëqyrjen e institucioneve për zbatimin e këtij ligji dhe obligon institucionin të veprojë në bazë të dispozitave të këtij ligji.

## **Neni 24**

24.1 Mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit të caktuar për punimin e vulës së institucioneve e bën Ministria e Punëve të Brendshme.

24.2 Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, Ministria e Punëve të Brendshme mund t'i urdhërojë vulëpunuesit t'i kthejë ose t'i asgjësojë të gjitha modelet, kallëpet si dhe të gjitha gjurmët tjera, të cilat kanë mbetur gjatë procesit të punimit të vulës dhe të përshtatë punën e tij me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e tjera në fuqi.

## **KREU V**

### **SANKSIONET KUNDËRVAJTËSE**

## **Neni 25**

25.1 Institucioni ndëshkohet me gjobë prej pesëqind (500) deri në pesëmijë (5.000) euro, në këto raste:

- a) nëse e porosit vulën pa marrjen e lejes nga Ministria,
- b) nëse nuk e njofton Ministrinë për humbjen e vulës,
- c) nëse personi i autorizuar për përdorimin e vulës nuk ka vendim me shkrim për përdorimin e saj,
- d) nëse vula nuk ruhet në kasafortë kur nuk është në përdorim,
- e) nëse nuk e shpall të pavlefshme vulën e humbur apo të papërdorshme dhe
- f) nëse vulën e papërdorshme nuk e dërgon në arkiv.

25.2 Personi përgjegjës i institucionit ndëshkohet me gjobë prej dyqind e pesëdhjetë (250) deri në dymijë e pesëqind (2.500) euro për shkeljet e parapara me paragrafin 25.1 të këtij neni.

## **Neni 26**

Vulëpunuesi ndëshkohet, me gjobë në shumën prej pesëqind (500) deri në pesëmijë (5.000) euro, në këto raste:

- a) nëse pa autorizim të institucionit e punon vulën të paraparë me dispozitat e këtij ligji,
- b) nëse nuk i kthen ose nuk i asgjëson të gjitha modelet, kallëpet ose mbetjet e tjera gjatë procesit të punimit të vulës dhe



c) nëse vulën ua jep personave të paautorizuar.

#### **Neni 27**

Dispozitat ndëshkuese të parapara sipas këtij ligji nuk i eliminon përgjegjësitë të tjera të parapara me dispozita ligjore në fuqi.

#### **Neni 28**

Gjobat e parapara sipas dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

### **KREU VI**

#### **DISPOZITAT KALIMTARE**

#### **Neni 29**

Institucionet janë të detyruara të përgatitin vulat e tyre sipas dispozitave të këtij ligji në afat prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 30**

Ky ligj shfuqizon çdo dispozitë ligjore që rregullon këtë materie.

#### **Neni 31**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-054**  
**30 korrik 2008**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

---

**Jakup KRASNIQI**